



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

NXJERRJA E NAFTËS, GAZIT DHE UJIT

Niveli i tretë në KSHK¹, referuar niveli III KEK²

X1-III-23

Tiranë, 2023

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar niveli III KEK	X1-III-23
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional në profilin “Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit”, niveli III ^{të} në KSHK, referuar niveli III KEK, është të përgatisë punonjës në nivelin e punëtorit të kualifikuar, për t’u punësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me fushën e nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit, në shërbimet e ofruara nga këto fusha, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kritere të përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në profilin “Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit”, të nivelit të tretë në KSHK, referuar niveli III KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar dy vitet e para të arsimit profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”, – janë të kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtijshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit”, niveli III në KSHK, referuar niveli III KEK, e pajis individin me Certifikatën profesionale dhe suplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë. Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si punëtor i kualifikuar në sipërmarrje të ndryshme që kryejnë veprimtari në nxjerrjen e naftës, të gazit dhe ujit dhe në kompani të ndryshme shërbimi në industrinë e naftës, si rievues, sondistit, përgjegjësit të kyçit, pontistit (punëtorit të manovrave), manovrator me traktor apo me autosondë për remontin nëntokësor, punëtorë të kyçit në remontin nëntokësor, si dhe pompistit e operatorit të prodhimit në grupet e grumbullimit dhe në stacionet e pompimit të këtyre produkteve; . Me arsimim të mëtijshëm individit dhe ai ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin e IV të KSHK, referuar nivelit IV të KEK, si teknik/menaxher dhe fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Data e validimit	Korrik 2023			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	X1-III-16			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

NJOHURI TE PERGJITHSHME

- Të shpjegojë dokumentacionin teknik të profesionit të rilevuesit, sondistit, përgjegjësit të kyçit, pontistit (punëtorit të manovrave), të manovratorit me traktor apo me autosondë për remontin nëntokësor, të punëtoreve të kyçit në remontin nëntokësor, pompistit dhe operatorit të prodhimit në grupet e grumbullimit dhe në stacionet e pompimit të këtyre produkteve;
- Të përshkruajë specifikat e mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në industrinë e naftës (punimet e shpimit dhe të shfrytëzimit);
- Të përshkruajë veçoritë e proceseve të punës së shpuesit, kryesondatorit, sondistit, pompistit, pontistit, shllamistit dhe motoristit të sondës së shpimit, manovratorit (traktorist apo shofer i autosondës), përgjegjësit të kyçit dhe punëtorit të dytë në remontin nëntokësor, të pompistit dhe operatorit të grupeve dhe stacioneve të pompimit.
- Të përshkruajë karakteristikat e pajisjeve në shfrytëzimin e naftës, gazit dhe ujit si: pompat e thellësisë, tubat e prodhimit, purtekat, lëkundësit, filtrat nëntokësore, pakerat, pajisjet dhe instrumentet që përdoren në remontin nëntokësor të puseve, pompat dhe kompresorët për transportin e naftës, gazit dhe ujit, aparatet për matjen e debiteve (prurjeve) të naftës, gazit dhe ujit etj.;
- Të shpjegojë vetitë fizike dhe kimike të naftës në kushtet e sipërfaqes dhe të shtresës në temperatura dhe presione të larta;
- Të shpjegojë vetitë kolektorale të shtresës dhe ndikimin e tyre në naftë-gaz dhe ujëdhënie;
- Të përshkruajë veçoritë e proceseve të punës së: kërkimit, shpimit dhe nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit;
- Të përshkruajë masat për parandalimin, si dhe rehabilitimin e mjedisit në shpimin e puseve, në nxjerrjen dhe në transportin e naftës, gazit dhe ujit;
- Të shpjegojë dokumentacionin teknik të profesionit të operatorit të nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit;
- Të përshkruajë specifikat e mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në industrinë e naftës (punimet e nxjerrjes dhe shpimit te puseve);
- Të përshkruajë veçoritë e proceseve të punës së operatorit të prodhimit, pompistit, punëtorit të pastrimit dhe motoristit.
- Të përshkruajë veçoritë e rreziqeve gjatë punës në industrinë e naftës (punimet e shpimit dhe të shfrytëzimit).

Përgatitja vendin e punës

- Të shpjegojë mënyrën e organizimit të kompanive të shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit;
- Të përshkruajë legjislacionin në fushën e hidrokarbureve;
- Të përshkruajë planimetrinë e vendndodhjes së puseve (layout);
- Të listojë mjetet, pajisjet dhe instrumentet e punës duke përshkruar funksionin dhe përdorimet e tyre;
- Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e kontrollit të funksionalitetit të mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit dhe ndarjen e detyrave;
- Të argumentojë rëndësinë e bashkëpunimit me specialistë të tjerë;
- Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve të punës, si dhe mjetet, materialet përkatëse;
- Të shpjegojë formatet dhe mënyrat e raportimit.

Vetitë e kolektorit dhe të fluideve që ngopin atë

- Të përshkruajë përbërjen, matriksin dhe porozitetin e shkëmbinjve, koeficientin e porozitetit dhe faktorët që ndikojnë në të;
- Të shpjegojë përshkueshmërinë e shkëmbinjve, përshkueshmërinë efektive (fazore) të tyre, përshkueshmërinë relative, bashkëlidhjen porozitet-përshkueshmëri dhe sipërfaqen specifike;
- Të argumentojë rreth veçorive dhe vetive kolektore të shkëmbinjve me çarje, parametrave e çarshmërisë, porozitetit dhe përshkueshmërisë së shkëmbinjve me çarje;
- Të shpjegojë vetitë e naftës si: përbërja kimike e naftës, dendësia dhe viskoziteti i naftës, si dhe ndikimi i tyre në procesin e shfrytëzimit;
- Të shpjegojë vetitë e gazeve si: vetitë fizike, përbërja e gazeve natyrore dhe gazeve hidrokarbure dhe dendësia e gazeve;
- Të shpjegojë vetitë e ujit si: përbërja kimike e ujit, cilësia e tij dhe ndikimi i tyre në procesin e shfrytëzimit;
- Të përshkruajë ujërat e shtresës, gjendja e tyre në shtratimet e naftë-gazmbajtëse dhe kripshmëria e ujit të shtresës;
- Të argumentojë proceset e shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit;
- Të listojë faktorët që ndikojnë në naftë, gaz dhe ujënxjerrje.

Kompletimi i puseve të shfrytëzimit

- Të listojë pajisjet nëntokësore dhe sipërfaqësore të puseve që shfrytëzohen me energjinë e shtresës (errupsion natyror);
- Të argumentojë domosdoshmërinë e kryerjes së studimit të puseve me errupsion natyror;
- Të përshkruajë skemën e përgatitjes së pusit për studimin e tij;
- Të listojë pajisjet e thellësisë së puseve të shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit, me secilën

nga metodat e shfrytëzimit;

- Të rendisë veçoritë në kompletimin dhe shfrytëzimin e puseve në det dhe në tokë;
- Të përshkruajë pajisjet e kolonës së shfrytëzimit dhe ato të grykës së pusit (armaturat e fontanës për presione të ndryshme pune, armaturat e fontanës të thjeshtuara), në rastet kur shfrytëzimi bëhet me fontanim natyror (errupsion), me fontanim artificial (kompresor) dhe me pompa thellësie të të gjitha llojeve;
- Të listojë radhën e veprimeve për vënien, e një pusi naftë, në shfrytëzim me fontanim natyror, me kompresor dhe me pompa thellësie, si dhe për vënien në shfrytëzim të një pusi gazi dhe uji;

Metodat e shfrytëzimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit

- Të klasifikojë metodat e shfrytëzimit parësor të puseve të naftës, të gazit dhe të ujit;
- Të argumentojë metodën e shfrytëzimit me fontanim natyror (errupsion) të puseve të naftës, gazit dhe të ujit;
- Të shpjegojë kalimin në metodën e shfrytëzimit me fontanim artificial të puseve të naftës, gazit dhe ujit, si dhe të argumentojë si funksionon kjo metodë;
- Të përshkruajë metodën e shfrytëzimit të puseve të naftës dhe të ujit me pompa thellësie;
- Të shpjegojë përdorimin e pompave hidraulike të thellësisë, pompave elektrocentrifugale zhytëse dhe pompave me burmë;
- Të shpjegojë veçoritë e kompletimit dhe të shfrytëzimit të puseve të gazit.

Vënia në punë e puseve

- Të shpjegojë faktorët natyrorë, teknikë dhe teknologjikë, që ndikojnë në ndotjen e shtresës kolektore;
- Të përshkruajë mënyrat e uljes së depresionit në fund të tij;
- Të përshkruajë punimet përgatitore për vënien e puseve në shfrytëzim (hapja e shtresës produktive, hermetizimi i kolonave të shfrytëzimit, perforimi i shtresave të naftës, gazit dhe ujit), konstruktionet e fundit të puseve në përshtatje me llojin e formacioneve të shtresës kolektore dhe me kushtet gjeologjike të tyre;
- Të argumentojë qëllimin dhe mënyrat e ndryshme të përvetësimit të pusit, në përshtatje me karakteristikat e shtresës kolektore;
- Të shpjegojë skemat teknologjike të metodave të përvetësimit të puseve;
- Të klasifikojë llojet e tubave të prodhimit (ose tubave pompë-kompresor), të purtekave, të nyjeve të tyre lidhëse, si dhe veglat dhe instrumentet që përdoren për ulje-ngritjen e tyre në pus.

Pajisjet e shfrytëzimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit me metoda të ndryshme

- Të përshkruajë pajisjet e grykës së pusit dhe të pajisjeve nëntokësore për shfrytëzimin me pompa thellësie dhe me llojet e tjera të pompave të thellësisë (me pompat elektrocentrifugale zhytëse, pompat me burmë, pompat hidraulike etj.);

- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e pompave të thellësisë dhe radhën e veprimeve për vënien e pusit në shfrytëzim;
- Të listojë pjesët kryesore të impiantit sipërfaqësor të nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit;
- Të shpjegojë pjesët e ndryshme të lëkundësit;
- Të argumentojë llogaritjen e debitit të pompës së thellësisë;
- Të vlerësojë koeficientin e mbushjes së pompës dhe kuptimin e tij;
- Të shpjegojë mënyrat specifike të shfrytëzimit të puseve me naftë shumë viskoze, siç janë: me injektim të holluesit në fund të pusit (me dhe pa paker), me metodat termike (injektimi i avullit, djegia nëntokësore etj.);
- Të përshkruajë pompat e injektimit të holluesit dhe anekset e tyre (automatet e injektimit, dozatorët, valvolat e moskthimit, lidhjet teknologjike etj.) në puset e naftës;
- Të shpjegojë shfrytëzimin e naftës viskoze me metodën CHOP (shfrytëzimin pa ulje të viskozitetit të naftës);
- Të përshkruajë proceset e matjes së prodhimit të naftës dhe gazit apo të presionit, në rezervuarë, depo dhe stacione grumbullimi me anën e kalimatësve të lëngjeve e të gazeve;
- Të argumentojë mënyrat e marrjes së kampioneve të naftës, ujit dhe gazit, për të analizuar në laborator vetitë fizike, kimike dhe parametrat e tjerë të tyre;
- Të shpjegojë përdorimin e aparateve për matjen dhe kontrollin e punës së pompës së thellësisë dhe të parametrave tekniko-teknologjike të pusit, siç janë dinamografi, eholloti, manometri dhe termometri i thellësisë, aparati për përcaktimin e pozicionit të kontaktit naftë-ujë në puset e vrojtimit etj.;
- Të përshkruajë rolin e duzës në shfrytëzimin me fontanë të puseve të naftës dhe të gazeve, si dhe veprimet për ndërrimin e saj, në përshtatje me studimin e pusit.

Monitorimi i prodhimit të grupit të puseve

- Të listojë hapat e fillimit të punës së monitorimit;
- Të shpjegojë procedurat për monitorimin e prodhimit ditor;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e manometrave për matjen e presionit;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e termometrave për matjen e temperaturës;
- Të shpjegojë llojin e pompës për përzierjen e naftës;
- Të shpjegojë mënyrën e matjes së prodhimit, si dhe mjetet dhe pajisjet përkatëse;
- Të shpjegojë funksionin e saraçineskave dhe veprimet me to;
- Të tregojë rrugën e lëvizjes së fluidit nga pusi drejt grupit përkatës;
- Të tregojë rrugën e lëvizjes së fluidit nga grupi përkatës drejt dekantimit;
- Të listojë anomalitë në parametrat e pompimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e parashikimit të anomalive të mundshme dhe mënyrën e parandalimit të tyre;
- Të përmbledhë të dhënat mbi ecurinë e punës dhe manovrat e kryera.

Grumbullimi dhe transporti i naftës dhe gazit

- Të shpjegojë skemat teknologjike për sistemet e grumbullimit të naftës në grupet e grumbullimit brenda vendburimeve dhe të stacioneve;
- Të përshkruajë rezervuarët matës dhe grumbullues, si dhe pajisjet e tjera (gazndarësit, saraçineskat, valvolat e sigurisë, rregullatorët e nivelit, etj.);
- Të shpjegojë parimin e ndarjes (seperimit) të gazit shoqërues të naftës nga nafta dhe rrugën që ndjek ai pas ndarjes;
- Të shpjegojë funksionimin e pompave të naftës dhe kompresorëve të gazit;
- Të shpjegojë funksionimin e grupeve të grumbullimit dhe transportit të naftës;
- Të rendisë veprimet gjatë kalimit të naftës nga pusi në kolektor, në rezervuarët e naftës deri në stacionin e grumbullimit të vendburimit;
- Të rendisë veprimet për ndarjen e rërës nga nafta bruto, në puset dhe grupet e vendburimeve të naftës në formacionet terrigjene;
- Të përshkruajë pajisjet dhe lidhjet teknologjike të një qendre për grumbullimin dhe shpërndarjen e gazit natyror;
- Të tregojë radhën e veprimeve ditore për kontrollin e tubacioneve të transportit të naftës e të gazit, në trasenë e shtrirjes së tyre;
- Të krahasojë veçoritë e grumbullimit të naftës dhe gazit, në vendburimet në tokë, në det;

Remonti sipërfaqësor dhe nëntokësor i puseve

- Të tregojë domosdoshmërinë e remontit nëntokësor të puseve të naftës, të gazit dhe të ujit;
- Të shpjegojë llojin e punimeve në rastet e veçanta;
- Të shpjegojë remontin e zakonshëm nëntokësor dhe remontin kapital të pusit;
- Të shpjegojë kompletimin e një pusi, në varësi të punimeve të remontit;
- Të përshkruajë instrumentet e peshkimit të tubove dhe të purtekave, në remontin e zakonshëm dhe në remontin kapital;
- Të shpjegojë radhën e punës dhe metodat, për pastrimin e tapave të rërës, në përputhje me veçoritë e çdo pusi (pus fontane apo pus me nivele të ulëta statike);
- Të rendisë veprimet për remontin nëntokësor të zakonshëm të puseve, që shfrytëzohen me injektim të holluesit, në rastet e skemave të ndryshme (me pakerim, pa pakerim);
- Të përshkruajë instrumentet për të ndërhyrë me punime të remontit kapital;
- Të shpjegojë veçoritë e riparimit nëntokësor të puseve në det dhe në tokë.

Shfrytëzimi i puseve horizontale në tokë dhe në det

- Të identifikojë veçoritë kryesore të shfrytëzimit të puseve horizontale në tokë dhe në det;
- Të shpjegojë pajisjet mbi dhe nëntokësore për puset horizontale;
- Të përshkruajë metodat e filtrimit në zonën pranë fundore dhe në shtresë;
- Të shpjegojë pajisjet dhe platformat e shfrytëzimit në det;
- Të shpjegojë kompletimin e puseve nëndetare;
- Të shpjegojë shfrytëzimin e puseve të naftës e të gazit në det dhe në tokë.

Metodat e rritjes së naftënxjerrjes

- Të përkufizojë konceptin e koeficientit të rritjes së naftënxjerrjes dhe të naftës fillestare të ndodhur në shtresë;
- Të argumentojë mundësinë, drejtimet e injektimit në zonën pranëfundore dhe të ndikimit në të;
- Të klasifikojë metodat e stimulimit në zonën pranëfundore, metodat e izolimit të ujërave dhe të perforimit të zonës pranëfundore;
- Të klasifikojë metodat e veprimit në shtresë;
- Të listojë përparësitë e zbatimit të secilës prej metodave, në përshtatje me kushtet gjeologjike, parametrat e shtresës, vetitë fizike dhe kimike të naftës, vetitë kolektore të shtresës etj.;
- Të shpjegojë teknologjinë e kryerjes së proceseve për rritjen e naftënxjerrjes;
- Të shpjegojë ç'është injektimi i ujit, injektimi i gazit karbonik, injektimi i avullit, djegia nëntokësore dhe injektimi i polimereve;
- Të listojë faktorët gjeologjikë dhe teknologjikë për zbatimin e secilës metodë veprimi në shtresë.

Trajtimi i fluideve të nxjerra nga pusët

- Të argumentojë ndarjen e fluideve në bazë të peshave specifike;
- Të shpjegojë mënyrën e shkarkimit të ujit të lirë në seperator;
- Të klasifikojë llojin e demulgatorit;
- Të shpjegojë rolin e demulgatorit dhe të temperaturës në trajtimin e fluidit;
- Të shpjegojë rastet e rishikimit të recepturës së demulgatorit gjatë procesit të trajtimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e parashikimit të afatit kohor të qetësisë për fluidin e trajtuar;
- Të shpjegojë procesin e shkarkimit të ujit të lidhur;
- Të listojë parametrat e zbatuara gjatë procesit të trajtimit të fluidit.

Shpimi i puseve

- Të përshkruajë veçoritë e sondave të shpimit sipas thellësisë së shpimit;
- Të shpjegojë funksionimin e pjesëve të një pompe shpimi;
- Të shpjegojë funksionimin e agregateve të fuqisë të një sonde shpimi;
- Të shpjegojë funksionimin e pajisjeve të sistemit të pastrimit të lëngut larës;
- Të shpjegojë funksionimin e preventorëve të fontanave dhe linjave anësore të tij;
- Të shpjegojë funksionet dhe përbërjen e kolonës së shpimit, tubos drejtuese, tubave të shpimit dhe atyre rëndues;
- Të shpjegojë funksionet dhe karakteristikat e tubave rëndues;
- Të shpjegojë kriteret e zgjedhjes së daltave për shpimin e një formacioni të caktuar;
- Të shpjegojë funksionimin e daltave për marrjen e kampionit dhe të kampionmarrësve;
- Të shpjegojë hapat për hartimin e konstruksionit të një pusi;
- Të shpjegojë mënyrat e mbërthimit dhe zbërthimit të elementëve të kolonës së rrethimit;

- Të përshkruajë etapat e procesit të çimentimit të një kolone rrethimi;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së suspensionit të çimentos dhe parametrat e tij;
- Të shpjegojë aparaturat dhe metodikat e matjes së parametrave të lëngut larës;
- Të shpjegojë shkaqet e ndërlikimeve gjatë shpimit të puseve;
- Të përshkruajë banjot me naftë, me acid etj. për zhbllokimin e instrumentit të bllokuar;
- Të shpjegojë ardhjen e fluideve nga shtresa (manifestimet), ardhjet e pakontrolluara (fontanat) dhe masat për nënshtrimin e ardhjeve së fluideve (fontanave).

Shëndeti, siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar dhe ndërkombëtar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të manualeve të përdorimit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive, sipas standardeve;
- Të rendisë parimet e përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në punimet e kërkimit, shpimit, të nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit, si dhe të shërbimeve të tjera në industrinë e naftës;
- Të përshkruajë kushtet e punës në punimet e kërkimit, shpimit të puseve, të nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit, si dhe të shërbimeve të tjera;
- Të listojë aksidentet e mundshme gjatë shpimit, nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit, si edhe të shërbimeve të tjera;
- Të përshkruajë rreziqet nga prania e gazeve helmuese në kantieret e shpimit dhe të nxjerrjes së naftës dhe gazit, në raste të manifestimeve apo edhe në rastet e fontanave të hapura;
- Të përshkruajë rreziqet nga pajisjet elektrike në kushtet e punës normale dhe në ditë me kushte të vështira atmosferike;
- Të përshkruajë dëmtimet e shëndetit nga zhurmat gjatë punës së sondave dhe të makinerive të tjera, masat mbrojtëse dhe pajisjet personale, dëmtimet e shëndetit nga kushtet e vështira atmosferike në periudhat e ftohta dhe me reshje dëbore;
- Të listojë burimet e mundshme të aksidenteve nga makineritë dhe mekanizmat që funksionojnë në sondën e shpimit, në traktorët dhe autosondat e remontit nëntokësor të puseve të nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit;
- Të shpjegojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë përdorimit të energjisë elektrike, si dhe rolin e ndriçimit dhe krijimin e kushteve të sigurta në punë;
- Të përshkruajë përdorimin e mjeteve të mbrojtjes individuale në punë gjatë montim – çmontimit të sondave dhe pajisjeve të shpimit, gjatë procesit të shpimit, ulje ngritjeve të instrumenteve, tubimit, çimentimit, likuidimit të avarive, përgatitjes dhe përdorimit të lëngut larës;
- Të përshkruajë përdorimin e mjeteve të mbrojtjes në punë gjatë kryerjes së punimeve të remontit nëntokësor, zbatimit të metodave të dyta, kryerjes së punimeve në zonën pranëfundore, veçanërisht kur përdoren acide;

- Të listojë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të shpjegojë elementët e sinjalistikës të vendosura në mjediset e punës;
- Të përshkruajë planin dhe procedurat e evakuimit në raste emergjence;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër gazit dhe zjarrit në vendin e punës;
- Të përshkruajë rregullat e përdorimit të pajisjeve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH).
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre;
- Të përshkruajë parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të përshkruajë procedurat e duhura për ndarjen e mbetjeve sipas llojit në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit racional të lëndëve të para, veglave të punës dhe të energjisë;
- Të përshkruajë zbatimin e protokolleve të duhura në raste pandemie.

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes së biznesit;
- Të përshkruajë llogaritjet e kostos së materialeve të punës, pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të kryera;
- Të shpjegojë mënyrën e hartimit të planeve ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të përshkruajë mënyrën dhe formatet e përgatitjes së raporteve periodike për shërbimet;
- Të shpjegojë mënyrat e ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit;
- Të përshkruajë rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe nevojën e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit të njohurive për aplikimin e teknikave e reja në punë;
- Të shpjegojë rëndësinë e nevojave për trajnim të vazhdueshëm;
- Të shpjegojë rëndësinë e pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me ngritjen profesionale të tij;
- Të përshkruajë metodat dhe kriteret e vlerësimit të performancës.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe teknikat përkatëse të tij;
- Të përshkruajë rëndësinë e shkëmbimit të informacionit mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të përshkruajë parimet dhe domosdoshmërinë e punës në grup;

- Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të hierarkisë;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e kodit të etikës dhe zbatimit të tij;
- Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës;
- Të shpjegojë teknikat e zgjidhjes së problemeve dhe mosmarrëveshjeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit teknologjive të reja të informimit dhe komunikimit;
- Të shpjegojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim.

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të lexojë/zbatojë dokumentacionin teknik për proceset e punës;
- Të përdorë pajisjet në shfrytëzimin e naftës, gazit dhe ujit si: pompat e thellësisë, tubat e prodhimit, purtekat, lëkundësit, filtrat nëntokësore, pakerat, pajisjet dhe instrumentet që përdoren në remontin nëntokësor të puseve, pompat dhe kompresorët për transportin e naftës e të gazit, aparatet për matjen e debiteve (prurjeve) të naftës, gazit dhe ujit etj.;
- Të zbatojë masat për parandalimin, si dhe rehabilitimin e mjedisit në shpimin e puseve, në nxjerrjen dhe në transportin e naftës, gazit dhe ujit;
- Të lexojë/zbatojë dokumentacionin teknik të profesionit të operatorit të nxjerrjes së naftës dhe gazit;
- Të zbatojë proceset e punës së: kërkimit, shpimit dhe nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit;
- Të kontrollojë rreziqet gjatë punës në industrinë e naftës (punimet e kërkimit, shpimit dhe të shfrytëzimit);
- Të zbatojë masat për parandalimin si dhe rehabilitimin e mjedisit në shpimin e puseve dhe në nxjerrjen e naftës, gazit dhe ujit;

Përgatitja vendin e punës

- Të zbatojë legjislacionin në fushën e hidrokarbureve;
- Të interpretojë planimetrinë e vendndodhjes së puseve (layout);
- Të përdorë mjetet, pajisjet dhe instrumentet e punës sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Të kontrollojë funksionalitetin e mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve të punës;
- Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Të kryejë organizimin dhe ndarjen e detyrave;
- Të bashkëpunojë me specialistë të tjerë në përgatitjen e vendit të punës;

- Të organizojë pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve të punës, si dhe mjetet, materialet përkatëse;
- Të respektojë formatet dhe mënyrat e raportimit.

Vetitë e kolektorit dhe të fluideve që ngopin atë

- Të kontrollojë përbërjen e matrisit dhe porozitetin e shkëmbinjve, koeficientin e porozitetit dhe faktorët që ndikojnë në të;
- Të përcaktojë përshkueshmërinë e shkëmbinjve, përshkueshmërinë efektive (fazore) të tyre, përshkueshmërinë relative, bashkëlidhjen porozitet-përshkueshmëri dhe sipërfaqen specifike;
- Të dallojë veçoritë e vetive kolektore të shkëmbinjve me çarje, parametrave të çarshmërisë, porozitetit dhe përshkueshmërisë së shkëmbinjve me çarje;
- Të vlerësojë vetitë e naftës si: përbërja kimike e naftës, dendësia dhe viskoziteti i naftës, si dhe ndikimi i tyre në procesin e shfrytëzimit;
- Të vlerësojë vetitë e gazeve si: vetitë fizike, përbërja e gazeve natyrore dhe gazeve hidrokarbure dhe dendësia e gazeve;
- Të vlerësojë vetitë e ujit si: përbërja kimike, cilësia dhe ndikimi i tyre në procesin e shfrytëzimit;
- Të kontrollojë proceset e naftë-gaz dhe ujënxjerrjes;

Të përcaktojë faktorët që ndikojnë në naftë-gaz dhe ujënxjerrje.

Kompletimi i puseve të shfrytëzimit

- Të dallojë pajisjet nëntokësore dhe sipërfaqësore të puseve që shfrytëzohen me energjinë e shtresës (errupsion natyror);
- Të zbatojë planin për kryerjen e studimit të puseve me errupsion natyror;
- Të interpretojë skemën e përgatitjes së pusit për studimin e tij;
- Të kontrollojë pajisjet e thellësisë së puseve të shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit, me secilën nga metodat e shfrytëzimit;
- Të përdorë pajisjet e kolonës së shfrytëzimit dhe ato të grykës së pusit (armaturat e fontanës për presione të ndryshme pune, armaturat e fontanës të thjeshtuara), në rastet kur shfrytëzimi bëhet me fontanim natyror (errupsion), me fontanim artificial (kompresor) dhe me pompa thellësie të të gjitha llojeve;
- Të përcaktojë radhën e veprimeve për vënien e një pusi naftë në shfrytëzim me fontanim natyror, me kompresor dhe me pompa thellësie, si dhe për vënien në shfrytëzim të një pusi gazi dhe uji.

Metodat e shfrytëzimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit

- Të përcaktojë metodat e shfrytëzimit parësor të puseve të naftës, të gazit dhe të ujit;
- Të zbatojë metodën e shfrytëzimit me fontanim natyror (errupsion), të puseve të naftës, gazit dhe të ujit;

- Të kryejë kalimin në metodën e shfrytëzimit me fontanim (errupsion) artificial të puseve të naftës dhe të argumentojë si funksionon kjo metodë;
- Të zbatojë metodën e shfrytëzimit të puseve të naftës dhe të ujit me pompa thellësie;
- Të përdorë pompat hidraulike të thellësisë, pompat elektrocentrifugale zhytëse dhe pompat me burmë;
- Të kryejë kompletimin me pajisjet e nevojshme sipas metodës, për shfrytëzimin e puseve të gazit dhe ujit.

Vënia në punë e puseve

- Të dallojë faktorët natyrorë, teknikë dhe teknologjikë, që ndikojnë në ndotjen e shtresës kolektore;
- Të kryejë veprimet për uljen e depresionit në fund të pusit;
- Të zbatojë punimet përgatitore për vënien e puseve në shfrytëzim (hapja e shtresës produktive, hermetizimi i kolonave të shfrytëzimit, perforimi i shtresave të naftës, gazit, ujit), konstruksionet e fundit të puseve në përshtatje me llojin e formacioneve të shtresës kolektore dhe me kushtet gjeologjike të tyre;
- Të përzgjedhë mënyrën e përvetësimit të pusit, në përshtatje me karakteristikat e shtresës kolektore;
- Të zbatojë një skemë teknologjike mbi mënyrën e përvetësimit të puseve;
- Të përzgjedhë llojet e tubave të prodhimit (ose tubave pompë-kompresor), të purtekave, të nyjeve të tyre lidhëse, si dhe veglat dhe instrumentet që përdoren për ulje-ngritjen e tyre në pus.

Pajisjet e shfrytëzimit të puseve të naftës me metoda të ndryshme

- Të kontrollojë pajisjet e grykës dhe të pajisjeve sipërfaqësore të pusit;
- Të kontrollojë funksionimin e pompave të thellësisë dhe të zbatojë radhën e veprimeve për vënien e pusit në shfrytëzim;
- Të mirëmbajë pjesët kryesore të impiantit sipërfaqësor të nxjerrjes së naftës;
- Të llogarisë debitin teorik të pompës së thellësisë;
- Të llogarisë koeficientin e mbushjes së pompës;
- Të zbatojë mënyrat specifike të shfrytëzimit të puseve me naftë shumë viskoze, siç janë: me injektim të holluesit në fund të pusit (me dhe pa paker), me metodat termike (injektimi i avullit, djegia nëntokësore etj.);
- Të përdorë pompat e injektimit të holluesit dhe anekset e tyre (automatet e injektimit, dozatorët, valvolat e moskthimit, lidhjet teknologjike etj.);
- Të demonstrojë metodën e shfrytëzimit të naftës viskoze me metodën CHOP (shfrytëzimin pa ulje të viskozitetit të naftës).
- Të kryejë procesin e matjes së prodhimit të naftës dhe gazit apo të presionit, në rezervuarë, depo dhe stacione grumbullimi me anën e kalimatësve të lëngjeve e të gazeve;

- Të marrë kampione të naftës, ujit dhe gazit, për të analizuar në laborator vetitë fizike, kimike dhe parametrat e tjerë të tyre;
- Të përdorë aparatet për matjen dhe kontrollin e punës së pompës së thellësisë dhe të parametrave tekniko-teknologjike të pusit, siç janë dinamografi, eholloti, manometri dhe termometri i thellësisë, aparati për përcaktimin e pozicionit të kontaktit naftë-ujë në puset e vrojtimit etj.;
- Të kontrollojë duzat dhe të kryejë veprimet e nevojshme për ndërrimin e tyre, në përshtatje me studimin e pusit, në shfrytëzimin me fontanë të puseve të naftës dhe të gazeve.

Monitorimi i prodhimit të grupit të puseve

- Të hartojë hapat e fillimit të punës së monitorimit;
- Të demonstrojë procedurat për monitorimin e prodhimit ditor;
- Të përdorë manometrat për matjen e presionit dhe termometrat për matjen e temperaturës;
- Të përdorë pompën për përzierjen e naftës;
- Të përcaktojë mënyrën e matjes së prodhimit, mjetet dhe pajisjet përkatëse;
- Të mirëmbajë dhe të përdorë në mënyrën e duhur saraçineskat;
- Të përcaktojë rrugën e lëvizjes së fluidit nga pusi drejt grupit përkatës;
- Të përcaktojë rrugën e lëvizjes së fluidit nga grupi përkatës drejt dekantimit;
- Të shmangë anomalitë në parametrat e pompimit;
- Të dallojë anomalitë e mundshme dhe mënyrën e parandalimit të tyre;
- Të hartojë të dhënat mbi ecurinë e punës dhe manovrat e kryera.

Grumbullimi dhe transporti i naftës dhe gazit

- Të lexojë skemat teknologjike për sistemet e grumbullimit të naftës në grupet e grumbullimit brenda vendburimeve dhe të stacioneve;
- Të dallojë rezervuarët matës dhe grumbullues, si dhe pajisjet e tjera (gazndarësit, saraçineskat, valvolat e sigurisë, rregullatorët e nivelit, etj.);
- Të demonstrojë ndarjen (seperimin) e gazit shoqërues të naftës nga nafta;
- Të monitorojë funksionimin e pompave të naftës dhe kompresorëve të gazit gjatë transportit të fluideve;
- Të monitorojë në mënyrë permanente, funksionimin e grupeve të grumbullimit dhe transportit të naftës për ndonjë anomali të mundshme;
- Të kryejë veprimet për lëvizjen e naftës nga pusi në kolektor, në rezervuarët e naftës deri në stacionin e grumbullimit të fluidit;
- Të kryejë veprimet e nevojshme për ndarjen e rërës nga nafta bruto, në puset dhe grupet e vendburimeve të naftës në formacionet terrigjene;
- Të skicojë pajisjet dhe lidhjet teknologjike të një qendre për grumbullimin dhe shpërndarjen e gazit natyror.

Remonti sipërfaqësor dhe nëntokësor i puseve

- Së bashku me brigadën e remontit të kryejë remontin e thjeshtë nëntokësor të puseve të naftës, të gazit dhe të ujit;
- Të përcaktojë llojin e punimeve në rastet e veçanta;
- Të lexojë skemën teknologjike për kompletimin e një pusi, në varësi të punimeve të remontit;
- Të përdorë dhe të mirëmbajë instrumentet e peshkimit të tubove dhe të purtekave, në remontin e zakonshëm dhe në remontin kapital;
- Të përcaktojë radhën e punës dhe metodat, për pastrimin e tapave të rërës, në përputhje me veçoritë e çdo pusi (pus fontane apo pus me nivele të ulëta statike);
- Të kryejë veprimet për remontin nëntokësor të zakonshëm të puseve, që shfrytëzohen me injektim të holluesit, në rastet e skemave të ndryshme (me pakerim, pa pakerim);
- Të përdorë instrumentet për të ndërhyrë me punime të remontit kapital;
- Të përcaktojë veçoritë e riparimit nëntokësor të puseve në det dhe në tokë.

Metodat e rritjes së naftënxjerrjes

- Të zbatojë metodat e stimulimit në zonën pranëfundore, metodat e izolimit të ujërave dhe të përforcimit të zonës pranëfundore;
- Të zbatojë metodat e veprimit në shtresë;
- Të zbatojë teknologjinë e kryerjes së proceseve për rritjen e naftënxjerrjes;
- Të kryejë injektimin e ujit, injektimin e gazit karbonik, injektimin e avullit, djegien nëntokësore dhe injektimin e polimereve sipas udhëzimeve të dhëna.

Trajtimi i fluideve të nxjerra nga pusët

- Të kryejë ndarjen e fluideve në bazë të peshave specifike;
- Të kryejë shkarkimin e ujit të lirë në separator;
- Të përcaktojë rastet e rishikimit të recepturës së demulgatorit gjatë procesit të trajtimit;
- Të zbatojë afatin kohor të qetësisë për fluidin e trajtuar;
- Të kryejë procesin e shkarkimit të ujit të lidhur.

Shpimi i puseve

- Të demonstrojë funksionimin e agregateve të fuqisë të një sonde shpimi;
- Të monitorojë funksionimin e pajisjeve të sistemit të pastrimit të lëngut larës;
- Të monitorojë funksionimin e preventorëve të fontanave dhe linjave anësore të tij;
- Të zbatojë kriteret e zgjedhjes së daltave për shpimin e një formacioni të caktuar;
- Të zbatojë llojin e daltave për marrjen e kampionit dhe të kampionmarrësve;
- Të kryejë mbërthimin dhe zbërthimin e elementëve të kolonës së rrethimit;
- Të kryejë, sipas projektit etapat e procesit të çimentimit të një kolone rrethimi;
- Të zbatojë procedurat për përgatitjen e suspensionit të çimentos dhe parametrat e tij;

- Të zbatojë metodikat e matjes së parametrave të lëngut larës;
- Të dallojë ndërlikimet e mundshme gjatë shpimit të puseve;
- Të kontrollojë ardhjen e fluideve nga shtresa (manifestimet), ardhjet e pakontrolluara (fontanat) dhe masat për nënshtrimin e ardhjeve të fluideve (fontanave).

Shëndeti, siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar dhe ndërkombëtar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të zbatojë manualët e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve dhe makinerive, sipas standardeve;
- Të zbatojë parimet e përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në punimet e kërkimit, shpimit, të nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit, si dhe të shërbimeve të tjera në industrinë e naftës;
- Të vlerësojë kushtet e punës në punimet e kërkimit, shpimit të puseve, të nxjerrjes së naftës, të gazit dhe ujit, si dhe të shërbimeve të tjera;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet e mundshme gjatë shpimit, nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit, si dhe të shërbimeve të tjera;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë për të shmangur rreziqet nga prania e gazeve helmuese në kantieret e shpimit dhe të nxjerrjes së naftës dhe gazit, në raste të manifestimeve apo edhe në rastet e fontanave të hapura;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së shëndetit nga zhurmat gjatë punës së sondave dhe të makinerive të tjera, masat mbrojtëse dhe pajisjet personale, dëmtimet e shëndetit nga kushtet e vështira atmosferike në periudhat e ftohta dhe me reshje dëbore;
- Të vlerësojë burimet e mundshme të aksidenteve nga makineritë dhe mekanizmat që funksionojnë në sondën e shpimit, në traktorët dhe autosondat e remontit nëntokësor të puseve të nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë përdorimit të energjisë elektrike, si dhe rolin e ndriçimit dhe krijimin e kushteve të sigurta në punë;
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes individuale në punë gjatë montim – çmontimit të sondave dhe pajisjeve të shpimit, gjatë procesit të shpimit, ulje-ngritjeve të instrumenteve, tubimit, çimentimit, likuidimit të avarive, përgatitjes dhe përdorimit të lëngut larës;
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes në punë gjatë kryerjes së punimeve të remontit nëntokësor, zbatimit të metodave të dyta, kryerjes së punimeve në zonën pranëfundore, veçanërisht kur përdoren acide;
- Të japë ndihmën së parë në rast aksidenti;
- Të respektojë sinjalistikën e vendosur në mjediset e punës;
- Të zbatojë planin dhe procedurat e evakuimit në raste emergjence;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër gazit dhe zjarrit në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e përdorimit të pajisjeve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH);

- Të marrë masa për eliminimin e ndotjes së ambientit;
- Të zbatojë parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të zbatojë procedurat e duhura për ndarjen e mbetjeve dhe depozitimin e tyre sipas llojit në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të përdorë në mënyrë racionale lëndët e para, veglat e punës, makineritë dhe energjinë;
- Të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie.

Sipërmarrja dhe edukimi i karrierës

- Të marrë informacion për ecurinë ditore të punës
- Të përzgjedhë mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të zbatojë legjislacionin në fuqi për detyrimet tatimore;
- Të zbatojë kodin e punës dhe rregulloren e brendshme;
- Të zbatojë aktet ligjore në fushën e hidrokarbureve;
- Të hartojë plane ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të regjistrojë ofertat dhe faturat për klientët për punimet e kryera;
- Të kryejë ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit;
- Të analizojë çmimet e tregut lidhur me materialet, pajisjet e punës, si dhe punimet e kryera;
- Të llogaritë koston e mjeteve, pajisjeve, materialeve dhe makinerive;
- Të llogaritë çmimin përfundimtar për punimet e ofruara;
- Të hartojë raportet periodike për shërbimet e kryera;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të nevojshëm për punimet e kryera;
- Të përdorë Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të përditësojë njohuritë për aplikimin e teknikave të reja në punë;
- Të bashkëpunojë me specialistët e tjerë në fushën e kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit;
- Të kryejë trajnime të vazhdueshëm sipas nevojës për rritje profesionale.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të zbatojë teknikat e komunikimit;
- Të bashkëpunojë për problemet dhe të rejat e ditës;
- Të punojë në grup duke zbatuar parimet përkatëse;
- Të respektojë hierarkinë;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të përdorë terminologjinë profesionale;
- Të zbatojë kodin e etikës;
- Të marrë dhe japë udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës;
- Të zbatojë teknikat e duhura për zgjidhjen e problemeve dhe mosmarrëveshjeve;

- Të zbatojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim.

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë, për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet, për çështje të ndryshme të fushës së shfrytëzimit të vendburimeve dhe të puseve të naftës, të gazit dhe të ujit.
- Të shfrytëzojë burime dhe teknika të ndryshme për grumbullimin e informacioneve të nevojshme në këtë fushë, për ngritjen e nivelit të tij profesional.
- Të pasurojë potencialin e tij të dijeve, për zgjidhje të reja më efektive dhe më efëiente, për rritjen e naftënxjerrjes.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme të karakterit profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale, etj..
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse, në veprimtaritë e ndryshme, që lidhen me të ardhmen e tij;
- Të zotërojë vetëkontroll dhe siguri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të punojë në grup dhe të respektojë parimet e punës në grup, për arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë drejt arritjet e tij, si bazë për t'i përmirësuar dhe çuar ato më tej, në funksion të interesave të grupit.